

STATUTI
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“SMIRNA” sh.p.k.

KREU I PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Formimi i Shoqerise

NENI 1

Shoqeria Tregetare “SMIRNA” sh.p.k, me seli qendrore ne adresen, Njesia Administrative Kashar, Rruga Sokrat Miho, Kompleksi Fratari, Ndertesa 12, Hyrja 2, Ap. 14 Tirane formohet nga ortaku themelues Kubilay Kaya

I cili me vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare”, si dhe Aktin e Themelimit, ka vendosur te destinoje ne kete Sipermarrje kapitalin e tij, me qellim qe te perfitojne te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e Shoqerise, si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne Kapitalin Themeltar.

Shoqeria ushton veprimtarine e saj ne baze te ekonomise se tregut te lire. Shoqeria tregtare “SMIRNA” sh.p.k, fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit te saj prane zyres se Qendres Kombetare te Rregjistrimit ne Tirane.

Forma, Emertimi,

NENI 2

1. Shoqeria tregtare, eshte e organizuar si Shoqi Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar.
2. Emertimi i Shoqerise eshte: “SMIRNA” sh.p.k.
3. Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare, mund te ruhet i njejt emertim, me kusht qe Personi Juridik te shtoje ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.

Selia, Territori

NENI 3

1. Shoqeria Tregetare “SMIRNA” sh.p.k, ka seline qendrore ne territorin e Republikes se Shqiperise, Njesia Administrative Kashar, Rruga Sokrat Miho, Kompleksi Fratari, Ndertesa 12, Hyrja 2, Ap. 14 Tirane
2. Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi apo agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.
3. Ajo mund te jete pjesemarrese ne nje shoqi tregtare apo mund te kontrolloje shoqi te tjera tregtare si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
4. Njesite strukturore te shoqerise ne format e mesiperme do te krijohen ne perputhje me legjislacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit te Republikes se Shqiperise, dhe jashte saj ne perputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendren e vet.
5. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kohezgjatja

NENI 4

1. Shoqeria Tregtare “SMIRNA” sh.p.k, do te permbushe objektin e veprimtarise se vet me nje afat te pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqerise duke perfshire edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje Personaliteti Juridik te ri.

Objekti

NENI 5

Shoqeria Tregtare “SMIRNA” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:



Tregti me pakice dhe shumice te te gjitha produkteve industriale, materiale ndertimi, produkte bujqesore dhe ushqimore.

Tregtimin me pakice te produkteve kozmetike dhe mjekesore.

Sherbime dhe konsulenca ne turizem, tregti nderkombetare dhe ne fushen e agro-turizem.

Transport tokesor mallrash kombetar dhe nderkombetar.

Shit-blerje te makinerive apo mjetete motorrike per perdonim tregtar, marrja apo dhenja e tyre me qira.

NENI 6

Shoqeria tregtare "SMIRNA" sh.p.k, nuk perggjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj.

Kapitali

NENI 7

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njeqind mijë) Leke**. 1 (nje) kuote gjithsej.

Ortaket e shoqerise jane:

1. **Kubilay Kaya**, zotëruesh i 1(nje) kuote me vlerë 100.000 leke, qe perfaqeson **100% (njeqind %)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

NENI 8

Shoqeria krijon fondin rezevre dhe fonde te tjera te vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar.

NENI 9

1. Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdonimi e rregullimi i çdo fondi te vecante percaktohen nga Ortaket sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2. Te ardhurat e perggitheshme te shoqerise dhe ne perggithesi çdo operacion finanziar i saj do te pasqyrohet ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.
3. Te ardhurat neto qe do te rezultojne nga bilanci i miratuar nga Vendimi i Ortakeve do te shperndehen si vijon: 5 % per fondin rezevre, deri sa ky fond te arrije 1/5 e kapitalit themeltar; ndersa pjesa tjeter ortakeve te saj ose do te shtohet ne kapital.

NENI 10

1. Shoqeria Tregetare "SMIRNA" sh.p.k, eshte pronare e pasurise se saj te cilin e perdon dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.
3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

NENI 11

1. Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti finanziar i shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit finanziar, raportet e vecanta te hartuara nga Ortaket dhe eventualisht nga eksperti i autorizuar miratohen me Vendim te Ortakeve te saj.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te trasferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi i pjesave te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbytjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithe ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjesa te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

NENI 14

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjesa ne shoqeri vetem me miratimin e Ortakeve.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributave ne para dhe ne natyre apo zvogelimi i tij behet me Vendimin e Ortakeve te shoqerise mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar.

KREU I DYTE

Ortakeria

NENI 16

Ortaket e shoqerise tregetare "SMIRNA" sh.p.k, gezojne te gjitha te drejtat dhe marrin persiper detyrimet qe pasqyrohen ne legjislatacionin e Republikes se Shqiperise, ne Aktin e Themelimit dhe ne Statutin e Shoqerise.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve

NENI 17

1. Te marre pjesa ne mbledhjet e Asamblese se Ortakeve duke ushtruar te drejten e votes se tij;
2. Te paraqese pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqerise ndaj administratorit;
3. Te informohet mbi permbytjen e raportit te administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve te propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel;
4. Te perfitoje nga fitimi i shoqerise;
5. Te kerkoje prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara;

KREU I TRETE

Administrimi i Shoqerise

NENI 18

1. Shoqeria do te administrohet nga administratori **Kubilay Kaya**, i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedje.
2. Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.
3. Shoqeria ne te ardhmen mund te administrohet dhe nga nje administrator tjeter, i cili emerohet me Vendim te Ortakeve.

Asambleja

NENI 19

1. Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise.
2. Ortaket mund t'i delegojne kompetencat e tyre me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.
3. Cdo klauzole e kundert eshte e pavlefshme ne kete rast.

NENI 20

Asambleja e Ortakeve ka te drejte :

1. Te hartoje e miratoje ndryshimet ne Statut;
2. Te miratoje bilancin vjetor te shoqerise;

3. Te vendose per zmadhimin apo zvogelinin e kapitalit themeltar te shoqerise;
4. Te emeroje dhe shkarkoje administratorin e shoqerise;
5. Te shpalle prishjen, likujdimin dhe falimentimin e shoqerise;
6. Te shprehet per kohezgjatjen e shoqerise;
7. Te miratoje marreveshjet arritura ne qarkullimin civil te saj;
8. Te miratoje strukturat e shoqerise etj.;
9. Çdo vendim tjeter qe i njihet nga ligji, Akti i Themelimit te shoqerise dhe Statutit te saj.

Proces verbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

Te drejtat e Administratorit

NENI 21

Administratori ka keto te drejta:

1. Te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet e saj me te tretet, ne administraten publike e ne organet gjyqesore;
2. Te emeroje prane shoqerise personelin e domosdoshem qe i nevojitet asaj ne perm bushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Te paraqese per miratim ne Asamblene e Ortakeve strukturen e brendshme organizative te shoqerise me emra perkates dhe te perm bushe te gjitha detyrimet ligjore qe rrjedhin nga legjislacioni i punes Republikes se Shqiperise;
4. Te administroje pasurine dhe mjetet financiare te shoqerise brenda kufijve te caktuara nga Asambleja e Ortakeve;
5. Te testoje aftesite e punonjesve ne administrate;
6. Te therrase Asamblene e Ortakeve dhe te propozojе çeshtjet qe duhen analizuar;
7. Te hartoje objektivat e shoqerise per çdo vit pasues dhe te vendose e te ndjeke realizimin e detyrave te lena nga Vendimet e marra nga Ortaket;
8. Te hartoje planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqese ato per miratim nga Asambleja e Ortakeve.

Te beje regjistrimin fillestar te shoqerise prane QKR Tirane apo te jape prokure per kryerjen e saj.

NENI 22

Administratori eshte per gjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 23

1. Shoqeria "SMIRNA" sh.p.k, emeron Ekspert Kontabel te Autorizuar.
2. Per emerimin, kompetencat, detyrimet, per gjegjesite, zevendesueshmerine, terheqjen, shkarkimin dhe shperblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

Marredheniet e Punesimit

NENI 24

1. Te gjithe personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, punesimi i tyre do te behet mbi bazen e kontrates individuale apo kolektive, sipas rastit, ne te cilin do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne kete fushe.
2. Marrja ne pune behet me rregjistrimin nga punedhenesi ne Librin e Punës se Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e Punës se Juridikzionit ku ushtron aktivitetin Shoqeria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punës per shkak te shkeljeve disiplinore ose me kerkesen e te interesuarit.
4. Mosmareveshjet qe mund te lindin gjate veprimitarise se Shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim te paleve, te cilat per kete qellim mund te caktojne nga nje perfaqesues me prokure. Kur mirekuptimi nuk eshte i mundur, palet i drejtohen Gjykates te Rrethit Gjyqesor.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 25

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut do te aplikohet Ligji "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare" si dhe Legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

NENI 26

Ky Statut hyn ne fuqi diten e regjistrimit te shoqerise ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit ne Tirane.

NENI 27

Ky Statut perpilohet ne 2 (dy) kopje originale secili me te njejten vlere ligjore. Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin base te shoqerise.

ORTAKU THEMELUES

KUBILAY KAYA

Kubilay Kaya
Jully

Tirane me 20.10.2022

*Gjerdhyes
Art. Pura*